

## Rezultatet e anketës së vlerësimit të studentëve për institucionin për vitin akademik 2023-2024

Për vitin akademik 2023-2024, numri i studentëve që kanë plotësuar anketën është 70 studentë me pjesëmarrje nga departamentet si më poshtë:

Shkenca Komunikimi 31.4%

Shkenca Kompjuterike 27.1%

Edukim dhe Gjuhë Angleze 17.1%

Drejtësi 5.7%

Shkenca Islame 7.1%

Ekonomi dhe Biznes 11.4%

Për sa u përket cikleve, 25.7% e pjesëmarrësve janë studentë të programeve master dhe 74.3% të programeve të ciklit të parë.

Vlerësimi më poshtë është bërë në bazë të 3 (tre) seksioneve me pohime të organizuara sipas shkallës Likert, dhe një (1) seksioni me sugjerime.

### A. Infrastruktura dhe Shërbimet

*Pyetja 1* Në lidhje me faqen e Webit të institucionit 84.3% e studentëve janë shprehur se janë dakord ose plotësisht dakord që faqja ofron një informacion të mjaftueshëm në lidhje me orarin mësimor, aktivitetet e ndryshme, regjistrimet etj. 8.6% e tyre janë pjesërisht dakord dhe pjesa tjetër (7.2%) nuk janë dakord me këtë pohim.

*Pyetja 2* Për sa u përket shërbimeve teknologjike të tilla si interneti, tabelat interaktive, kompjuterat, etj., 72.9 % e studentëve janë të kënaqur me këto shërbime, 15.7% e tyre ndajnë një mendim neutral dhe 11.4% e studentëve nuk janë të kënaqur me këto shërbime.

*Pyetja 3* Mbi 93% e studentëve mendojnë se procesi i regjistrimit të lëndëve në BIS është i lehtë, 3% ndajnë mendim neutral dhe 4% nuk janë dakord me këtë pohim.

*Pyetja 4* 88.5% e studentëve janë plotësisht dakord ose dakord që në Sistemin BIS gjejnë informacione në lidhje me programin e studimit, 7.1% janë pjesërisht dakord dhe pjesa tjetër (4%) nuk janë dakord.

*Pyetja 5* Për marrjen e dokumenteve të nevojshme (vërtetim studentit, transkript, etj) në një kohë

të shkurtër 80% e studentëve janë shprehur se bien shumë dakord ose dakord, 14.3% e tyre janë pjesërisht dakord dhe 5.7% e tyre nuk janë dakord.

*Pyetja 6* 84.3% e studentëve janë shumë të kënaqur me komunikimin që kanë me njësitë administrative (departamentin, fakultetin, etj.), 11.4% e tyre kanë një mendim të mesëm dhe pjesa e mbetur (4.3%) nuk janë të kënaqur.

*Pyetja 7* Për sa i përket shërbimit të bibliotekës 85.7% e studentëve janë të kënaqur nga ky shërbim, 11.4% e tyre janë pjesërisht të kënaqur dhe 2.8% e tyre nuk janë të kënaqur.

*Pyetja 8* 77.1% e studentëve bien dakord që janë të kënaqur me bibliotekën online JSTOR, 20% e tyre janë pjesërisht të kënaqur, 2.9 % nuk janë aspak të kënaqur.

*Pyetja 9* Për 41.4% të studentëve literatura e bibliotekës është plotësisht e mjaftueshme, për 31.4% të tyre kjo literaturë është e mjaftueshme, 22.9% e tyre kanë mendim neutral dhe pjesa e vogël e mbetur mendojnë se kjo literaturë nuk është e mjaftueshme.

*Pyetja 10* Për pohimin se ambientet e mësimit janë të bollshme dhe motivuese, 75.7% e studentëve bien dakord dhe shumë dakord, 15.7% e tyre janë pjesërisht dakord dhe 8.6% e tyre nuk janë dakord ose aspak dakord.

*Pyetja 11* Në lidhje me kushtet higjieno-sanitare, 90% e studentëve janë të kënaqur, 8.6% e tyre janë pjesërisht të kënaqur dhe vetëm 1.4% e tyre nuk janë të kënaqur.

*Pyetja 12* Në lidhje me nivelin e kënaqshmërisë që kanë studentët me ambientet sociale të institucionit 80% e tyre shprehen se janë shumë të kënaqur, 15.7% e tyre janë pjesërisht të kënaqur dhe vetëm 4.3% e tyre nuk janë të kënaqur.

Si përfundim,

Për sa i përket website-it dhe teknologjive që ofron institucioni mund të themi se shumica e studentëve ndajnë një mendim pozitiv, një pjesë e vogël e tyre kanë një qëndrim të mesëm (15%) dhe një pjesë shumë e vogël e tyre kanë mendim negativ.

Mbi 90% e studentëve mendojnë se BIS është shumë i lehtë për tu përdorur, 3% ka një mendim neutral dhe një pjesë shumë e vogël ka vështirësi me sistemin.

Në lidhje me komunikimin me zyrat administrative shumica e studentëve janë të kënaqur, një

pjesë e konsiderueshme e tyre janë pjesërisht të kënaqur. Edhe në lidhje me bibliotekën një pjesë e konsiderueshme janë pjesërisht të kënaqur, shumica janë të kënaqur.

**Në përgjithësi studentët janë të kënaqur me të gjitha shërbimet në masën mbi 70-75%. Ndërkohë që shërbimi më i vlerësuar në lidhje me infrastrukturën janë kushtet higjieno-sanitare dhe lehtësia e regjistrimit të lëndëve në BIS, vlerësimi më i ulët është për literaturën e bibliotekës që është plotësisht e mjaftueshme në masën 41.4%.**

### **B.Mbështetja dhe këshillimi akademik**

*Pyetja 13* 84.3% e studentëve pjesëmarrës janë të kënaqur me këshillimin akademik, 11.4% kanë mendim neutral dhe 4.3% nuk mendojnë se këshillimi akademik është në nivele të kënaqshme.

*Pyetja 14-15* Në lidhje me organizimin e semestrit të verës, vetëm rreth 5.8% shprehen se nuk janë të kënaqur me këtë mundësi, 20% janë neutral dhe 74.3% janë të kënaqur me këtë mundësi. Për sa i përket organizimit të riprovimeve apo provimeve shtesë, 82.9% e vlerësojnë pozitive këtë mundësi, 14.3% janë neutralë dhe vetëm 2.9% nuk janë dakord me këtë mundësi.

*Pyetja 16* 82.8% e studentëve mendojnë se organizimi i aktiviteteve akademike në institucion është i mjaftueshëm, 12.9% janë neutralë dhe 4.3% mendojnë se numri i aktiviteteve akademike nuk është i mjaftueshëm.

**Mbështetja dhe këshillimi akademik kanë marrë një vlerësim të përgjithshëm pozitiv në masën mbi 80%. Përqindja e të vlerësuarit negativisht ose shumë negativisht është shumë e vogël.**

### **C.Mbështetja nga dekanati i studentit**

Në lidhje me mbështetjen që u ofrohet studentëve nga dekanati i studentit dhe zyrat përkatëse, është përdorur nga një pyetje për secilën zyrë.

*Pyetja 17-18* 78.6% e studentëve janë të kënaqur me aktivitetet e klubeve studentore, 17.1% kanë mendim neutral dhe vetëm 4.3% janë të pakënaqur me organizimet e kësaj zyre.

Pothuajse i njëjti rezultat paraqitet edhe në lidhje me aktivitetet social-kulturore, ku 80% shprehen se ato janë të mjaftueshme, 12.9% shprehin mendim neutral dhe 7.2% shprehen se nuk janë të mjaftueshme.

*Pyetja 19* Në lidhje me shërbimet e zyrës psiko-sociale 65.7% shprehen të kënaqur, 27.1% janë neutralë dhe 7.2% shprehen se janë të pakënaqur.

*Pyetja 20* Edhe në lidhje me zyrë e karrierës vihet re një tablo pozitive, ku 77.2% shprehen të kënaqur, 17.1% e studentëve janë neutralë dhe 5.8% shprehen të pakënaqur.

#### **D. Sugjerime dhe komente nga studentët**

Në pjesën e komenteve dhe sugjerimeve, studentët janë shprehur në lidhje me pikat e mëposhtme:

##### **Infrastruktura**

1. Mundësia për të pasur mense me pagesë për studentet.
2. Sistem më të mirë kondicionimi
3. Përmirësim dhe përditësim i teknologjisë sidomos në bibliotekë, si dhe shtimi i mundësive për të praktikuar paketën Microsoft Office
4. Riorganizim më i mirë i librave të bibliotekës për lehtësim të gjetjes së tyre
5. Vendosja e grilave në bibliotekë
6. Akses i ujit të pijshëm vazhdimisht tek holli

##### **Mbështetja akademike**

1. Organizimi më i pakët i seminareve, konferencave apo aktiviteteve të cilësuar të padobishme për studentet.
2. Krijimi i partneriteteve me organizata apo institucione të njohura
3. Rishikimi i lëndëve, heqja e lëndëve teorike dhe shtimi i lëndëve praktike

### **Mbështetja nga dekanati i studentit**

1. Më shumë mundësi praktike.

2. Komunikim më i mirë nga stafi administrativ me studentët si dhe komunikim më i mirë mes stafit akademik dhe atij administrativ.

### **Përfundime**

Analiza e rezultateve të anketës, nxjerr në pah se për të gjitha shërbimet vlerësimi është pozitiv dhe varion nga 70% deri në 85%. Nuk ka asnjë shërbim për të cilin studentët të shprehin pakënaqësi totale ose në masë të gjerë. Bazuar në analizën e përgjigjeve të anketës, NJSBC bën rekomandimet e mëposhtme:

1. Rishikimi i infrastrukturës dhe përshtatja me nevojat dhe kërkesat e studentëve. Krijimi i një mjedisi të posaçëm për studentët për shërbimin e ushqimeve dhe pijeve.

2. Bashkëpunim më i gjerë ndërmjet njësive përkatëse për ofrim të individualizuar të shërbimeve si këshillim karriere (mundësi internshipi, praktike dhe studime të mëtejshme) dhe këshillim akademik, kryesisht për përfshirje në veprimtari akademike.